

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarve A. B. dhe D. B., të dy nga fshati Zh., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KP-së. sipas aktakuzës të Prokurorisë themelore në Prizren PP.nr.755-2/2016 të datës 22.06.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren, Beqë Shala, të akuzuarve si dhe mbrojtësi të akuzuarës D. B., avokat H. S., me datë 24.01.2017, publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.A. B., nga i ati S. dhe nëna I. e lindur I., i lindur me datë *data e lindjes...*, në Prizren, tani jeton në fshatin zh., Komuna e Prizrenit, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i martuar, baba i pesë fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së dobët ekonomike,

2.D. B., nga i ati A. dhe nëna F. e lindur S., e lindur me datë *data e lindjes...*, në fshatin zh., Komuna e Prizrenit, ku edhe tani jeton, student, e shkurorëzuar, nënë e një fëmijut, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, gjendjes së mesme ekonomike.

J A N Ë F A J T O R

Se i pandehuri A. B.,

I.Me datën 03.04.2016, rreth orës 14,00, në fshatin Zh., Komuna e Prizrenit, i shkakton lëndime të lehta trupore personit tjetër, i cili rezulton me dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, në atë mënyrë që për shkak të probleme familjare në mes të pandehurit dhe vajzës së tij – të pandehurës D. B., në lidhje me martesën e saj dhe pas një fjalosje në mes tyre i pandehurit e sulmon fizikisht të pandehurën duke e goditur me grushta në fytyrë, me ç' rast i shkakton lëndime të lehta trupore dhe atë: gjake mbledhje nën lëkurore në regjionin e këndit të syrit të majtë të fytyrës, lëndime të përshkruara më për së afërmi në mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjeko ligjor, të datës 05.05.2016,

Këso dore ka kryer veprën penale lëndim të lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KP-së.

Se e pandehura D. B.,

II.Me datë, kohë dhe vend të njëjtë të përshkruar si në dispozitivin e parë të kësaj aktakuzë i shkakton lëndime të lehta trupore personit tjetër, i cili rezulton me dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, në atë mënyrë që për shkak të problemeve familjare në

mes të pandehurës dhe babait të saj – të pandehurit A. B., në lidhje me martesën e saj dhe pas një fjalosje në mes tyre e pandehura e sulmon fizikisht të pandehurin duke e goditur me grushta dhe shqelma në fytyrë dhe në pjesë të ndryshme të trupit, me ç’ rast i shkakton lëndime të lehta trupore dhe atë: ndrydhje (mbretje) të indeve të buta me gërvishtje lëkurore të regjionit të mollëzës së faqes së majtë të fytyrës dhe gjak mbledhje nën lëkurore në anën e djathtë të gjoksit, lëndime të përshkruara më për së afërmi në mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjeko ligjor, të datës 05.05.2016,

Këso dore ka kryer veprën penale lëndim të lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KP-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7,41,43 par.1 pika 1.3, 46, 73,74,75, dhe 188 të KP-së,të akuzuarit i shqipton:

Të akuzuarit të parë A. B.

DËNIM ME GJOBË

Në lartësi prej 200 (dyqind) euro, të cilën shumë është i obliguar të paguaj në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgu duke llogaritur për çdo 20 euro, një ditë burg, respektivisht 10 ditë burg,

Të akuzuarës të dytë D. B.

DËNIM ME GJOBË

Në lartësi prej 200 (dyqind) euro, të cilën shumë është i obliguar të paguaj në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgu duke llogaritur për çdo 20 euro, një ditë burg, respektivisht 10 ditë burg,

Obligohen të akuzuarit të paguajnë në mënyrë solidare shpenzimet e procedurës penale dhe ato në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumë prej 20,00 euro dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor secili veç e veç në shumë prej 20 euro,të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë të këtij aktgjykimi,nën kërcnim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.755-2/2016 të datës 22.06.2016, kundër të akuzuarve A. B. dhe D. B., të dy nga fshati Zh., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KP-së.

Prokurori i shtetit Beqë Shala, në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: qëndroj pranë aktakuzës PP.nr.755/2016 e datë 22.06.2016, kundër të akuzuarve A. B. dhe D. B., të dy nga

fshati Zh., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KP-ës, dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit, duke u bazuar në dispozitat e KP, meqenëse këtu të akuzuarit në shqyrtimin fillestar në mënyrë vullnetare e pranuan fajësinë për veprat penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që ti merr parasysh të gjitha rrethanat cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese ti merr parasysh pranimin e fajësisë nga të akuzuarit në mënyrë vullnetare për veprat penale të cilat ju vihen në barë

I akuzuari i parë A. B., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranojë veprën penale cila më vihet në barë, ka qenë një moment kur nuk kam mundur ta kontrolloj vet vetën dhe veprimet e mia kanë qenë veprime në momentin e efektit, të dëmtuarën nga ana ime e kam bijë, me të njëjtën jetojmë në bashkësi të njëjtë familjare, tani jemi në raporte të shëndosha familjare, andaj duke pasur parasysh të cekurat, si dhe pranimin e fajësisë nga ana ime, jam person familjar, baba i pesë fëmijëve, kjo është hera e parë që kam ra në konflikt me ligjin si dhe premtimin tim që nëtë do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla apo të ngjashme të gjitha këto rrethanat konsideroj dhe i propozoj gjykatës që ti merr si rrethanat lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Mbrojtësi i të akuzuarës së dytë D. B., avokat H. S., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: që momenti i kryerjes së veprës penale nga ana e të mbrojturës sime siç theksoj edhe i akuzuari i parë në fjalën e tij përfundimtare, që për ndryshe është i dëmtuar në veprimet e të mbrojtëses time, ka qenë në momentin e mosmarrëveshjes të raporteve familjare gjegjësisht raportit bijë – baba, e të cilat veprime kanë qenë veprime të shkaktuara në momentin e afektit, dhe për pasojë kanë shkaktuar edhe veprën penale, por pasi që e mbrojtura ime e pranoi fajësinë, atëherë lidhur me gjendjen faktike nuk kam çka të kontestoj, por i propozoj gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, konform dispozitave ligjore të ketë parasysh rrethanat lehtësuese në dobi të mbrojturës sime dhe atë pranimin e saj vullnetar të fajësisë, kërkim falje për veprimet e veta, raportet e shëndosha familjare me të akuzuarin e parë, raportet e tyre tani janë të përmirësuara, janë në raporte që jetojnë në bashkësi të njëjtë familjare, e po ashtu duhet të ketë parasysh edhe faktin e moshës të mbrojturës sime, rrethanat e saja personale, është nënë e një fëmijë, është person familjar, si dhe faktin që e njëjta premtim që në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, të gjitha këto rrethanat konsideroj dhe i propozoj gjykatës ti merr si rrethanat lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

E akuzuara D. B., në fjalën e saj përfundimtare deklaron, në tërësi e përkrah dhe e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim, dhe për momentin nuk kam tjetër çka të shtoj.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se i pandehuri A. B.,

I.Me datën 03.04.2016, rreth orës 14,00, në fshatin Zh., Komuna e Prizrenit, i shkakton lëndime të lehta trupore personit tjetër, i cili rezulton me dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, në atë mënyrë që për shkak të problemeve familjare në mes të pandehurit dhe vajzës së tij – të pandehurës D. B., në lidhje me martesën e saj dhe pas një fjalosjeje në mes tyre i

pandehurit e sulmon fizikisht të pandehurën duke e goditur me grushta në fytyrë, me ç' rast i shkakton lëndime të lehta trupore dhe atë: gjake mbledhje nën lëkurore në regjionin e këndit të syrit të majtë të fytyrës, lëndime të përshkruara më për së afërmi në mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjeko ligjor, të datës 05.05.2016,

Se e pandehura D. B.,

II. Me datë, kohë dhe vend të njëjtë të përshkruar si në dispozitivin e parë të kësaj aktakuzë i shkakton lëndime të lehta trupore personit tjetër, i cili rezulton me dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, në atë mënyrë që për shkak të problemeve familjare në mes të pandehurës dhe babait të saj – të pandehurit A. B., në lidhje me martesën e saj dhe pas një fjalosje në mes tyre e pandehura e sulmon fizikisht të pandehurin duke e goditur me grushta dhe shqelma në fytyrë dhe në pjesë të ndryshme të trupit, me ç' rast i shkakton lëndime të lehta trupore dhe atë: ndrydhje (mbretje) të indeve të buta me gërvishtje lëkurore të regjionit të mollëzës së faqes së majtë të fytyrës dhe gjak mbledhje nën lëkurore në anën e djathtë të gjoksit, lëndime të përshkruara më për së afërmi në mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjeko ligjor, të datës 05.05.2016,

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve të cilët në shqyrtimin fillestar vullnetarisht kanë pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se egziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila ju vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë për të cilat të akuzuarit kanë qenë të njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhë në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me neni 248 të KPP dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KP-së, dhe për këtë gjykata të akuzuarit i shpalli fajtor dhe ju shqiptoi dënimin me kusht paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tyre penalo juridike.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethanë rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve, sjellja korrekte e tyre pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë i tyre, gjer më tani të pa gjykuar, çka nënkupton se nuk kanë ardhur ndesh me rregullat pozitive, në kuptim të dispozitave të nenit 74 gjykata vlerësoi rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarve, moshën e të akuzuarve, janë persona familjar, dhe atë i akuzuari i parë është baba i pesë fëmijëve, e po ashtu edhe e akuzuara e dytë është nënë e një fëmijut, raportet e tyre familjare, ngase të akuzuarit në raporte prind fëmijë, respektivisht i akuzuari i parë është baba i të akuzuarës së dytë, bashkëpunimin e përgjithshëm të akuzuarve me gjykatën, pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, shprehja e keqardhjes të akuzuarve për veprën penale të shkaktuar, si dhe sjelljen korrekte të tyre gjatë shqyrtimit si dhe pas veprës penale të shkaktuar, andaj gjykata ju shqiptoi veç e veç dënimet dhe atë të akuzuarit të parë A. B. dënimin me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, të cilën shumë është i obliguar të paguaj në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet

as me detyrim i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 euro, një ditë burg, respektivisht 10 ditë burg, si dhe të akuzuarës së dytë D. B., dënimin me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, të cilën shumë është i obliguar të paguaj në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 euro, një ditë burg, respektivisht 10 ditë burg, duke menduar se dënimi i shqiptuar ju përgjigjet shkallës së përgjegjësisë të tyre dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe shpenzimet mbi paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1368/2016 me datë 24.01.2017

Procesmbjatesja
Naxhis Sharani

Gjyqtari,
Luan Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.